AMMK - Sukseset dhe të arriturat kryesore!

- **Raportet e publikuara:**
  -Gjendja e mjedisit ne Kosovë, 2008
  -Gjendja e natyrës-2008, Natyra, 2009
  -Gjendja e Mbeturinave, 2008
  -Gjendja e Ujërave, 2010
  -Identifikimi hapësinorë i ndotësve potencial, 2009
  -Kadastri i ndotësve të ujërave, 2010.

- **Konferencat e organizuara:**
  -Mbrojtja e Mjedisit përmes Efiçiencës së Energjisë 2006,
  -Monitorimi dhe Raportimi Mjedisor, Nevojat dhe Mundësitë 2007.
  -Praktikat, Mundësitë,Veprimet-Mbrojtja e Mjedisit dhe Efiçenca e Energjisë 2008.

- **Bashkëpunimi me EEA dhe EIONET**
  -Mars 2010, Involvimi i AMMK në EIONET,
  -Është caktuar NFP (National Focal Point) dhe është Zhvilluar rrjeti i NRC (National Reference Centres) për 23 qendra referente,
  -Pjesëmarrje në 8 workshope dhe disa takime të organizuar nga EEA dhe EIONET,
  -Është dorëzuar raporti për emisionet ne ajër, raporti për biodiversitetin dhe raporti për gazrat serë,
  -Janë shkëmbyer informacione dhe përvoja për raportet, politikat dhe të arriturat në lëmin e mjedisit.


AMMK - 5 vjet !

Me datën 5 qershor 2006 është funksionalizuar dhe ka filluar punën e saj Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Funksionalizmi i AMMK-së ka sjellë një kontribut të çmueshëm në avancimin, përmirësimin, dhe në përshpejtimin e zgjidhjes së çështjeve mjedisore në Kosovë.

AKMM me punën e saj mbulon tri rrafshe kryesore mjedisore: monitorimin e gjendjes së mjedisit, sistemin e informimit mjedisore dhe raportimin për gjendjen e mjedisit.

Përmes përcjelljes dhe vlerësimit të gjendjes së mjedisit, grumbullimit dhe përpunimit të informacioneve për mjedisin dhe presionet në mjedis si dhe Raportimit për gjendjen e mjedisit dhe sektorë të tij, AMMK përveç që ka informuar publikun ka nxjerrë përfundime dhe ka dhënë rekomandime për vendimmarrësit për përcaktimin e politikave mjedisore të së ardhmes, dhe për ndërmarrjen e masave mbi preventiven dhe kontrollin mjedisor.



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

5 QERSHORI

DITA BOTËRORE E MJEDISIT



PYJET : NATYRA NË SHËRBIMIN TUAJ

AMMK

PESË VJET

5 Qershori - Dita Botërore e Mjedisit

5 Qershori u caktua si Dita Botërore e Mjedisit në vitin 1972, nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-s.

U zgjodh kjo datë sepse përkon me ditën e hapjes e Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin, që u mbajt në vitin 1972 në Stokholm, nën udhëheqjen e Programit Mjedisor të Kombeve të Bashkuara (UNEP).

Qëllimi i shënimit të kësaj ngjarje është të nxisë aktivitete dhe aksione për të arritur ndryshime pozitive në mbrojtjen e mjedisit.

Shënimi i kësaj dite zakonisht përcillet me një tematikë të caktuar. Në të kaluarën tema të kësaj ngjarje kanë qenë kujdesi për tokën dhe ujin, mbrojtja e shtresës së ozonit, ndryshimet klimatike dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Adresa: Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04
Tel. +381 38 200 33 228
email: kepa@ks-gov.net

Pse festohet Dita Botërore e Mjedisit?

Kur ne shohim dhe përjetojnë efekte negative në mjedis sikur janë ndryshimet klimatike dhe degradimi i mjedisit, zakonisht hapen debate duke fajësuar njëri-tjetrin: qeverinë që nuk i ka dhënë prioritet politikave mjedisore, operatorët ekonomik për ngritjen e emisioneve të gazrave serrë, organizatat joqeveritare për lobim të pamjaftueshëm për mjedisin dhe individët për mos marrjen e masave.

Dita Botërore e Mjedisit megjithatë është një ditë e në të cilën kërkohet të lihen anash dallimet në mes grupeve me qëllim që të demonstrohen arritjet dhe angazhimet për mbrojtjen e mjedisit. Duke festuar Ditën Botërore të Mjedisit, ne i kujtojmë vetes dhe të tjerët për rëndësinë e kujdesit për mjedisin tonë.

Për këtë qëllim Dita Botërore e Mjedisit festohet në mbarë botën në shumë mënyra, duke përfshirë edhe mitingje në rrugë, parada të biçiklistëve, koncerte të gjelbra, ese, gara e konkurse nëpër shkolla, duke mbjellë pemë, duke organizuar fushata pastrimi si dhe duke shpërndarë fletushka dhe materiale tjera vetëdijesimi.

www.ammk-rks.net

Dita Botërore e Mjedisit dhe Pyjet

Organizata e Kombeve të Bashkuara ka shpallur vitin 2011 Vit Botëror të Pyjeve me qëllim të rritjes së informimi dhe angazhimi për ruajtjen e kësaj pasurie të madhe të planetit. Pyjet u japin strehë njerëzve dhe kafshëve, ruajnë shumëllojshmërinë biologjike, janë burim i ujit, ajrit të pastër, ushqimit dhe barnave mjekësore. Ato kanë rëndësi të madhe edhe në ruajtjen e klimës së planetit për faktin se ndihmojnë në reduktimin e sasisë së dyoksidit të karbonit, i cili është një nga shkaktarët kryesorë të ngrohjes globale. Prandaj Dita Botërore e Mjedisit këtë vit shënohet me moton “Pyjet: Natyra në shërbimin tuaj”.

